



**KOLEGJI
UNIVERSITAR I BIZNESIT**

REKTORI



Dedon.

Rr. "Vangjel Noti" Nr.25, pranë AMC Laprakë, Tiranë, Tel:04 2454 893, mob:0674008880, Web:www.kub.edu.al, Email: info@kub.edu.al

Nr. 54, prot.

Tiranë, më 12.02.2019

**Drejtuar: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)**

Tiranë

**Lënda: Përgjigje Tuajes Nr.329, datë 15.01.2019 për kriteret e pranimit të studentëve
në "Kolegjin Universitar të Biznesit", për vitin akademik 2020-2021.**

Mbështetur në kërkesat që parashtrohen nga ana e juaj, me shkresën nr.Nr.329, datë 15.01.2019 "Për kriteret e pranimit në programet e studimit të IAL- për vitin akademik 2020-2021", Ju bëjmë me dije se në njësitë kryesore të IALP "Kolegji Universitar i Biznesit" Tiranë, për vitin akademik 2020-2021, kriteret e pranimit të studentëve janë si më poshtë:

1. Pranimi në ciklin e parë të studimeve

Fakultetet e Kolegjit Universitar të Biznesit, do të pranojnë studentë në programet e studimit të ciklit të parë në përputhje me përcaktimet e nenit 74, të Ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kandidatët që pranohen duhet të kenë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave. Renditja e studenteve që do të aplikojnë në programet studimore që zhvillohen pranë secilit prej fakulteteve në "Kolegjin Universitar të Biznesit" Tiranë, për regjistrime në ciklin e parë Bachelor do të bëhet duke mbajtur në konsideratë pikët që grumbullohen nga studentët sipas mesatares së lëndëve të Shkollës së Mesme, bashkë me notat e provimeve të maturës shtetërore.

2. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve

Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Drejtësisë në KUB, do të pranojnë studentë në programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", në përputhje me përcaktimet e nenit 76, të Ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kandidatët që pranohen duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 74, të ligjit, të kenë përfunduar me sukses një program studimi të ciklit të parë në fushën e ekonomisë, drejtësisë apo fusha të tjera të përafërta dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore.

3. Pranimi në programet e studimeve të larta profesionale 2-vjeçare

Kolegji i studimeve të Larta Profesionale në KUB do të pranojnë studentë në programet e studimit të ciklit të parë në përputhje me përcaktimet e nenit 74, të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Renditja e studenteve që do të aplikojnë në programet studimore që zhvillohen pranë Kolegji i studimeve të Larta Profesionale në KUB, për regjistrime në programet profesionale do të bëhet duke mbajtur në konsideratë pikët që grumbullohen nga studentët sipas mesatares së lëndëve të Shkollës së Mesme, bashkë me notat e provimeve të maturës shtetërore.

Në përfundim të çdo faze, Institucioni i arsimit të lartë: KUB pas përzgjedhjes së kandidatëve, do të shpallë listat e kandidatëve fitues në portalin U-Albania **për secilin program studimi** dhe po kështu listat do t'i dërgohen, Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), duke zbatuar kërkesat ligjore dhe nënligjore që lidhen me këtë proces.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, me konsideratë.

REKTORI I “KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT”

Prof.Dr. Leandro HAXHI

@matura_shtetërore

